



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KËSHILLI I LEGJISLACIONIT

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR KËRKESËN PËR SHKARKIMIN E KRYETARIT TË KUVENDIT
TË SHQIPËRISË, ZOTIT NIKO PELESHI**

*(Propozuar nga deputetët e shumicës parlamentare
në Këshillin për Legjislacionin)*

HYRJE

Këshilli për Legjislacionin, në cilësinë e organit përgjegjës parlamentar, në përputhje me nenet 14 dhe 114, pikat 1 dhe 4, të Rregullores së Kuvendit, nën drejtimin e zonjës Aulona Bylykbashi, kryesuese e Këshillit për Legjislacionin, në mbledhjet e datave 6.10.2025 dhe 14.10.2025, mori në shqyrtim kërkesën e 36 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike drejtuar Këshillit për Legjislacionin me shkresë nr. 2529, në datën 19.09.2025, “Për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Niko Peleshi”.

Këshilli për Legjislacionin në mbledhjen e datës 6.10.2025, pasi relativitetit të kërkuarve nëpërmjet anëtarëve përfaqësues në Këshill, për të përgatitur raportin, caktoi në cilësinë e relatorëve z. Damian Gjoknuri, i propozuar nga deputetët e shumicës parlamentare dhe z. Ivi Kaso, i propozuar nga deputetët e pakicës parlamentare. Këshilli zhvilloi gjithsej 3 mbledhje.

II. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

▪ **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

Neni 75

1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet.
2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.

Neni 76

1. Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët.

▪ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Neni 6

Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

2. Kryetari i Kuvendit zgjidhet pa debat dhe me votim të fshehtë, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 7

Kryetari i Kuvendit

1. Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme Kuvendit dhe strukturave të tij.

2. Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, Kryetari u jep fjalën deputetëve dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, drejton dhe modern në mënyrë të paanshme debatet, siguron rendin në seancë plenare, cakton radhën e votimeve dhe njofton rezultatin e tyre.

5. Kryetari i Kuvendit, në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare, vendos për propozime të deputetit/deputetëve për të mbajtur heshtje solemne në seancë plenare.

6. Në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tij, Kryetari i Kuvendit nxjerr urdhra dhe udhëzime.

Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, Kryetari u jep fjalën deputetëve dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, drejton dhe modern debatet, siguron rendin në seancë plenare, cakton radhën e votimeve dhe njofton rezultatin e tyre, kujdeset për respektimin e Rregullores së Kuvendit duke marrë masa disiplinore të parashikuara në të, pezullimin e punimeve kur është i pamundur zhvillimi normal i tyre. **(Bazuar në nenet 64, 64/1, 64/2, 65/1 të Rregullores së Kuvendit.)**

Kryetari i Kuvendit drejton dhe thërret mbledhjet e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, si dhe Byronë e Kuvendit dhe Konferencën e Kryetarëve. **(Nenet 8/2, 12/2, 13/2 të Rregullores së Kuvendit.)**

Neni 13

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

1. Këshilli është organ këshillimor, i cili kryen funksione të vlerësimit ose të dhënies së mendimit për çështje të procedurave, që lidhen me funksionimin dhe vendimmarrjen e Kuvendit si më poshtë:

a) propozimet për ndryshimin e Rregullores;

b) interpretimin e Rregullores, sipas nenit 116 të saj;

c) interpretimin e Kodit të Sjelljes dhe udhëzuesit të Kodit të Sjelljes, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Sjelljes në këtë Rregullore;

ç) mosmarrëveshjet në lidhje me kompetencat ndërmjet komisioneve të Kuvendit;

d) vlerësimin periodik dhe rishikimin e Kodit të Sjelljes në rastet e parashikuara në Kodin e Sjelljes;

dh) çështje të tjera të parashikuara nga kjo Rregullore

6. Këshilli mblidhet me kërkesën e Kryetarit të Kuvendit ose 1/2 së anëtarëve. Rendi i ditës caktohet nga Kryetari. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë. Diskutimi i çështjeve në Këshill bëhet, për aq sa është e mundur, në mënyrën e parashikuar për komisionet e përhershme.

7. Në përfundim të diskutimeve, Këshilli i paraqet Kryetarit raportin, i cili përmban të gjitha qëndrimet për çështjen. Raporti i përcillet seancës plenare brenda dy javëve nga përfundimi i shqyrtimit të çështjes. Raporti paraqitet nga relatori/relatorët.

Neni 27/1

Rendi i ditës i seancës plenare

“3. Rendi i ditës miratohet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit dhe bëhet publik si rregull 7 ditë përpara, por jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar në seancën plenare”

Neni 28

Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve

1. Me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një të pestës së të gjithë numrit të deputetëve, Kuvendi mund të shqyrtojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar.

2. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, me përjashtim të shkronjës “dh”. Projektligji që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European nuk shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar.

3. Kërkesa për procedurë të përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjit paraqitet me shkrim te Kryetari i Kuvendit, i cili ia njofton Kuvendit në seancën plenare më të parë. Pas njoftimit të Kryetarit dëgjohet një folës pro dhe një folës kundër për jo më shumë se 10 minuta. Kryetari i

Kuvendit i paraqet Kuvendit për votim projektvendimin përkatës, në të cilin përcaktohet data e shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës, afati brenda të cilit mund të propozohen amendamente dhe data e shqyrtimit në seancë plenare. Konferenca e Kryetarëve mund të përcaktojë kohën e debatit në seancë plenare, duke respektuar rregullin e parashikuar në nenin 48 pika 3 të kësaj Rregulloreje.

4. Afati, brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja në komision dhe në seancë plenare, nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare.

5. Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se tri projektligje me procedurë të përsheptuar në programin 9-javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj në kalendarin 3-javor të punimeve të tij.

Neni 31

Ndryshimi i rendit të ditës

2. Për të diskutuar ose vendosur në seancë plenare për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Kuvendi merr vendim me jo më pak se tre të pestat e deputetëve të pranishëm. Propozimet për vendosje të çështjeve të tjera në rend të ditës duhet të paraqiten me shkrim nga të paktën 10 deputetë, nga një kryetar grupi parlamentar ose nga Këshilli i Ministrave vetëm para fillimit të seancës, para fillimit të diskutimit të një pike të rendit të ditës ose kur është pezulluar diskutimi. Në rastet kur kërkesën nuk e bën grupi parlamentar, kërkesa paraqitet nga një deputet dhe grupi mbështetës i deputetëve ngrihet në këmbë.

Neni 110

Miratimi i programit politik dhe i përbërjes së Këshillit të Ministrave

1. Data e seancës plenare për miratimin e programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 97 të Kushtetutës, përcaktohet nga Kryetari i Kuvendit në marrëveshje me Kryeministrin.

2. Programi politik i Këshillit të Ministrave dhe përbërja e tij paraqiten në Kuvend nga Kryeministri.

3. Pas paraqitjes së programit politik, çdo deputet dhe grup parlamentar ka të drejtë të paraqesë pyetje për Kryeministrin.

4. Pas përgjigjeve të pyetjeve, Kryetari i Kuvendit deklaron hapjen e debatit për programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve, në përputhje me nenin 48 të kësaj Rregulloreje. Në përfundim të debatit, pas fjalës së kryetarëve të grupeve parlamentare, ka të drejtë të flasë Kryeministri jo më shumë se 10 minuta. Votimi nga Kuvendi i përbërjes dhe i programit politik të Këshillit të Ministrave bëhet sipas nenit 58 të kësaj Rregulloreje.

Neni 116

Interpretimi i Rregullores

1. Kur ngrihen pretendime gjatë zhvillimit të seancës plenare lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje, është kompetencë e drejtuesit të seancës për të vendosur për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.

▪ **Kodi i Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë¹**

Neni 5

Dispozitë e përgjithshme

1. Deputeti, gjatë ushtrimit të mandatit, shfaq standardet më të larta të sjelljes së qytetëruar, dinjitoze dhe të etikës parlamentare korrekte.

Neni 6

Gjuha jo parlamentare dhe diskriminuese.

1”Përdorimi i gjuhës së pahijshme, fyese ose kërcënuese, ofendimet dhe sulmet fizike personale janë rreptësisht të ndaluara

III. BAZA LIGJORE PROCEDURALE

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Neni 114

Shkarkimi i anëtarëve të organeve Kushtetuese

1. “Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë dhe nga jo më pak se 28 deputetë, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj. Me paraqitjen e kërkesës, Kryetari i Kuvendit vë menjëherë në dijeni Kuvendin dhe anëtarin e organit kushtetues për të cilin kërkohet shkarkimi.”

4. “Kërkesa për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit paraqitet sipas pikës 1 të nenit 114 dhe shqyrtohet nga Këshilli për Legjislacionin, i cili paraqet raportin përkatës në seancë plenare. Në rast se kërkohet, Këshilli për Legjislacionin dhe Kuvendi në seancë plenare janë të detyruar të dëgjojnë Kryetarin e Kuvendit. Në këtë rast seanca plenare drejtohet nga Zëvendëskryetari që i përket shumicës parlamentare.”.

Neni 14

Këshillit për Legjislacionin

1. Këshilli është organ këshillimor, që vlerëson ose jep mendim për çështje kushtetuese ose ligjore që ngrihen në lidhje me tekstin e projektligjit dhe për çështje të harmonizimit të

¹ Vendim nr. 61/2018 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”.

projektligjit me aktet e tjera ligjore në fuqi ose me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe aktet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

2. Këshilli për Legjislacionin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendi, pasi ka marrë më parë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Këshilli siguron përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. Anëtarët e Këshillit janë me profesion jurist ose të kenë përvojë legjislative.

3. Këshilli për Legjislacionin kryesohet me rotacion çdo 5 muaj nga secili anëtar, duke filluar sipas renditjes alfabetike të mbiemrit, duke ruajtur parimin e kryesimit një herë nga shumica dhe një herë nga pakica parlamentare.

6. Kryetari i Kuvendit, bazuar në kërkesën e paraqitur, përcakton rendin e ditës. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë. Diskutimi i çështjeve në Këshill bëhet, për aq sa është e mundur, në mënyrën e parashikuar për komisionet e përhershme.

IV. RRETHANAT DHE ARGUMENTET E PARASHTRUARA NGA KËRKUESIT

Në kërkesën e depozituar nga 36 deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike parashtrohet se Kryetari i Kuvendit:

1. Ka thirrur mbledhjen e Kuvendit në seancën e datës 16 shtator 2025 në kundërshtim me pikën 3 të nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, duke sjellë pasojën e parashikuar nga pika 2 e nenit 78 të Kushtetutës - mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas Rregullores nuk sjellin asnjë pasojë.

2. Ka thirrur mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në kundërshtim me nenin 83, pika 2, të Kushtetutës, pikën 4 të nenit 28 dhe nenin 117 të Rregullores së Kuvendit

3. Ka përfshirë në votim akte, të cilat janë miratuar në Kuvend në kundërshtim me procedurën kushtetuese të miratimit, duke shkelur nenin 83, pika 3, të Kushtetutës së Shqipërisë, pikën 4 të nenit 28 dhe nenin 117 të Rregullores së Kuvendit

4. Në seancën plenare të datës 18.09.2025 i ka mohuar kryetarit të Grupit Parlamentar të PD të drejtën e fjalës për procedurë, në kundërshtim me nenin 49 të Rregullores së Kuvendit, dhe këtë të drejtë ia ka njohur kryetarit të Grupit Parlamentar të PS-së dy herë rresht, duke shfaqur njëanshmëri të theksuar në drejtimin e seancës.

5. Nuk ka mundësuar paraqitjen e programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave nga Kryeministri; ka mohuar të drejtën e deputetëve për të bërë pyetje përpara procesit të votimit; nuk ka lejuar debat parlamentar përpara procesit të votimit, ka mohuar të drejtën e kryetarëve të grupeve parlamentare për të diskutuar në përfundim të debatit parlamentar, në kundërshtim me nenin 97 të Kushtetutës dhe nenin 110 të Rregullores së Kuvendit.

Kërkuesit pretendojnë se kryetari i Kuvendit, z. Niko Peleshi, duke thirrur mbledhjen e Kuvendit dhe të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, duke u mohuar deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë të drejtën për pyetje, të drejtën për të diskutuar lidhur me çështjet e përfshira në rendin e ditës, ka vepruar në shkelje të neneve 78, 83, pika 2, dhe 97 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të neneve 27/1, pika 3, 28, pika 4, 49, 73 dhe 117 të Rregullores së Kuvendit, duke përdhosur parlamentarizmin dhe minuar funksionimin demokratik të Kuvendit.

V. SHQYRTIMI NË KËSHILLIN PËR LEGJISLACIONIN TË KËRKESËS

Këshilli për Legjislacionin në mbledhjen e datës 6.10.2025 u njoh me kërkesën e një grupi prej 36 deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike nëpërmjet prezantimit të deputetit Ivi Kaso, anëtar i Këshillit.

Në lidhje me kërkesën, deputeti Ivi Kaso iu referua drejtimit të seancave të datave 16 shtator dhe 18 shtator, në të cilat sipas kërkuesve Kryetari i Kuvendit, pavarësisht se ishte i sapozgjedhur, ka kryer veprime aktive në kundërshtim të hapur me parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me Rregulloren e Kuvendit, duke u mohuar, sipas vlerësimit të kërkuesve, të drejtat deputetëve të opozitës dhe duke treguar njëanshmëri politike në drejtimin e organit të rëndësishëm kushtetues, Kuvendit të Shqipërisë, përgjegjësi e cila sapo i ishte besuar.

Shkeljet e konsumuara nga Kryetari i Kuvendit, sipas kërkuesve, në këto dy seanca nuk kanë të bëjnë vetëm me shkelje të natyrës procedurale, por kanë të bëjnë pikërisht me mohimin në thelb të të drejtës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për të diskutuar në mënyrë konstruktive lidhur me efektivitetin e ndryshimeve të propozuara të Rregullores, përshtatshmërinë e tyre dhe, pse jo, thyerjen e një tradite parlamentare, nisur që nga viti 2013, me anë të së cilës ndryshimi i Rregullores së Kuvendit është bërë me konsensus.

Sipas kërkuesve, ndryshe nga konsensusi që ka patur Kuvendi në miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, si një vlerë e një shoqërie demokratike, në seancën e datës 16.9.2025 në kundërshtim me çka parashikon Kushtetuta, me procedurë të përshpejtuar u vendos miratimi i ndryshimit të Rregullores, u bë mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në kundërshtim me nenin 83, pika 2, të Kushtetutës dhe me nenin 117 të Rregullores së Kuvendit, u përfshi për votim dhe miratim në Kuvend. Me këto veprime, Kryetari i Kuvendit në ditën e parë të punës vendos të shkelmojë Kushtetutën, mbi të cilën sapo ishte betuar, si dhe hedh praktikisht në plehra Rregulloren, e cila shumë shpejt u amendua në mënyrë të jashtëligjshme.

Sipas kërkuesve, edhe në seancën e datës 18.9.2025, vetëm 2 ditë më vonë, në një nga seancat më të rëndësishme të një legjislature, ku diskutohet programi i Këshillit të Ministrave, prezantohen ministrat, u jepet e drejta deputetëve të opozitës për t'i drejtuar pyetje Kryeministrit dhe ministrave lidhur me programin, i cili synohet të zbatohet në 4-vjeçarin në vijim, janë konsumuar shkelje të rënda të Kryetarit të Kuvendit duke shkelur Rregulloren, që sapo kishte hyrë në fuqi, sapo ishte miratuar me procedurë të përshpejtuar, në kundërshtim me Kushtetutën dhe me dispozitat që rregullojnë miratimin e ligjeve me procedurë të përshpejtuar, dhe ku Kryeministri praktikisht e drejtoi seancën e datës 18, dhe jo Kryetari i Kuvendit.

Reagimi i deputetëve të pakicës parlamentare, sipas kërkuesve, u provokua nga Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit *de facto* ndërpreu seancën. Drejtimi i seancave plenare të Kuvendit të datave

16 dhe 18 shtator 2025 nga Kryetari i Kuvendit, sipas kërkesve, është një dhunim i Kushtetutës dhe Rregullores duke i dhënë fjalën Kryeministrit, i cili provokoi reagimin e opozitës. Për kërkesit, kryetari i Kuvendit, duke ndërprerë seancën, i mohoi të drejtën e fjalës opozitës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Kuvendit duhet të burojnë nga detyrimet kushtetuese në radhë të parë, nga detyrimet e Rregullores së Kuvendit, të cilat proceduralisht detajojnë dhe detyrojnë sjelljen e të gjithëve ne, qoftë në komisione, qoftë në seancat plenare, *iter-in* se si duhet të miratohen ligjet, ndryshimet e Rregullores, praktikisht gjithçka, për të cilën ky Kryetar Kuvendi deri tani ka shfaqur shpërfillje maksimale. Kjo ka qenë arsyeja për të cilën ne jemi drejtuar me një kërkesë për shkarkimin e tij.

Në mbledhjen e datës 15.10.2025, rreth kërkesës diskutuan deputetët e pakicës parlamentare, anëtarë në Këshill, të cilët në diskutimet e tyre u qëndruan pretendimeve të ngritura në kërkesën e 36 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Deputeti Arian Ndoja, shprehu mendimin e tij se është shkelur Rregullorja e Kuvendit, për pasojë edhe neni 78, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Neni 13, pika 1, e Rregullores lejon Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të shqyrtojë propozime për ndryshimin e Rregullores, por në rastin konkret, menjëherë pas zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, pa u organizuar fare as këshillat dhe as komisionet përkatëse, madje asnjë nga parlamentarët që kanë qenë në seancë nuk e kanë pasur në dispozicion Rregulloren, u kalua në miratimin e ndryshimeve të reja të Rregullores, duke shkelur kështu të gjithë procedurën parlamentare të normuar nga Rregullorja, e cila parashikon se duhet të konstituohet Këshilli, të merret në shqyrtim propozimi për ndryshime në Rregullore dhe më pas të kalohet për votim në seancë plenare.

Gjithashtu, deputeti Arian Ndoja i kërkoi Këshillit që në vazhden e shkeljeve të Kryetarit të Kuvendit të shtohet si shkelje të Rregullores nga Kryetari i Kuvendit edhe mosdhënia e fjalës atij për të diskutuar jashtë rendit të ditës.

Relatori Ivi Kaso i caktuar nga **anëtarët e pakicës parlamentare në Këshillin për Legjislacionin**, në diskutimin e tij **përsëriti kërkesën** e paraqitur nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, **për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë**, duke kërkuar edhe në emër të anëtarëve të Këshillit për Legjislacionin, që përfaqësojnë Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, Kuvendit të Shqipërisë shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit **për shkelje të rënda të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit**, veçanërisht për veprimet dhe mënyrën e drejtimit të seancës, konkretisht në dy seancat plenare të mbajtura në datën 16 shtator, në orën 10:00 dhe në orën 12:30, si dhe në datën 18 shtator në orën 10:00.

Në diskutimet e deputetëve të pakicës parlamentare dhe relatorit Kaso, shkeljet e kryera nga kryetari i Kuvendit janë të rënda dhe përfshijnë si shkelje të Kushtetutës, ashtu edhe shkelje të Rregullores së Kuvendit, veçanërisht në momentin e thirrjes së mbledhjes së seancës plenare, shkelje të cilat kanë të bëjnë me futjen në rendin e ditës të shqyrtimit me procedurë të përshpejtuar të ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, të cilat kanë qenë propozim i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, sikundër edhe miratimi që është bërë në po të njëjtën seancë,

pasi është mbledhur Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, i ndryshimeve të propozuara në Rregullore.

Për të gjitha këto momente procedurale, sipas deputetëve të pakicës parlamentare, Kryetari i Kuvendit kishte përgjegjësinë kushtetuese si drejtues i institucionit më të lartë të vendit, përfaqësuesit të drejtpërdrejtë të sovranit, por edhe si rregullator procedural i çdo aspekti, qoftë ky formal apo substancial, i ndryshimeve në ligje dhe në Rregullore. Sipas tyre, ushtrimi i aktivitetit ligjvënës, që është aktiviteti i vetë Kuvendit, është shoqëruar me shkelje të rënda, të cilat u kanë pamundësuar dhe u kanë mohuar fjalën jo vetëm opozitës parlamentare, jo vetëm përfaqësuesve të atyre shtetasve dhe atyre zgjedhësve që nuk i kanë dhënë besimin kësaj mazhorance, por, mbi të gjitha, interesit qytetar.

Në emër të deputetëve të shumicës parlamentare në Këshillin për Legjislacionin, deputeti Damian Gjijnuri, në cilësinë e relatorit, duke vlerësuar veprimtarinë e Këshillit për Legjislacionin në lidhje me kërkesën si një procedure *quasi* hetimi administrativ, u ndal dhe e analizoi atë në aspektin formal dhe substancial të saj.

Nga pikëpamja formale, kërkesa plotëson kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, ndërsa nga pikëpamja substanciale, thelbi i kërkesës ka pasur të bëjë me dy-tri elemente kryesore të shkeljeve substanciale, që siç pretendohet, diktojnë nevojën e shkarkimit të Kryetarit të Kuvendit.

E para: lidhet me afatet e zhvillimit të mbledhjes dhe me pretendimet për njëanshmëri në ndryshimin e Rregullores, duke mos respektuar afatin e caktuar 7-ditor, të cilin Kushtetuta dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese e njohin për ligjet.

Në debatin nëse barazohet Rregullorja e Kuvendit me ligjin, relatori vlerëson se Rregullorja është një akt *sui generis*, është i veçantë, është rregullore e brendshme, dhe duke qenë se është Rregullore e Kuvendit, është një akt publik. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka vlerësuar se Rregullorja është akt *sui generis* i brendshëm i Kuvendit të Shqipërisë, i cili është sovran, dhe vendos vetë rregullat e tij për mënyrën e organizimit të mbledhjeve, të organizimit në mënyrë demokratike. Aspekti 7-ditor nuk është fare shkelje e karakterit kushtetues, që ta motivojë këtë kërkesë për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit. Nga ana tjetër ndryshimet që u propozuan nuk kishin të bënin aspak me të drejta procedurale apo kufizime të të drejtave të deputetëve, por për shtimin e numrit të komisioneve të përhershme, ku edhe nga opozita; nuk pati asnjë kundërshtim për sa i përket substancës apo nevojës pse duheshin këto komisione. Duke iu referuar vendimit nr. 1, datë 16.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese, deputeti Gjijnuri theksoi se “*jo çdo mosrespektim i Rregullores sjell pavlefshmërinë kushtetuese. Pavlefshmëria - sipas Gjykatës Kushtetuese lind vetëm në ato raste kur shkelja procedurale cenon drejtpërdrejt dispozitat kushtetuese ose pengon ushtrimin e të drejtave themelore të deputetëve*”.

Për çështjen të cilën kanë ngritur kërkuessit, procedura e ndjekur ka respektuar afatin e arsyeshëm, projekti ishte dhënë në kohë, ishte e deklaruar edhe publikisht që këto do të jenë komisionet, madje nën tavolinë palët kishin filluar, me të drejtë, të bënin rialokimet e tyre të burimeve njerëzore brenda grupeve parlamentare.

Referuar argumenteve të parashtruara, relatori Gjiknuri vlerësoi **se pretendimi i kërkuesve nuk qëndron dhe duhet rrëzuar duke sugjeruar që Këshilli t'i propozojë seancës plenare që kërkesa për shkarkimin e Kryetarit për këtë shkelje të pretenduar të rrëzohet.**

Së dyti: Në lidhje me shkeljen tjetër të pretenduar nga kërkuesit për ndërprerjen, sipas opozitës, e fjalës së tyre, mundësisë për t'u shprehur dhe për të diskutuar programin e qeverisë, deputeti Gjiknuri analizoi parimin e rregullsisë dhe të rendit në zhvillimin e mbledhjeve të Kuvendit. Sipas këtij parimi duhet të respektohet tjetrin, ta dëgjosh, të flasësh në kohën e duhur dhe pa cenuar dinjitetin e tjetrit.

Në fjalën e tij, deputeti Gjiknuri iu referua procesverbalit të seancës plenare të Kuvendit në datën 18.10.2025, duke theksuar se *“Kuvendi filloi me një procedurë krejt normale. Kryeministri i Shqipërisë, sipas Rregullores, paraqiti programin për qeverinë. Të gjithë palët kishin marrë masa për ta mbështetur apo për ta demaskuar, goditur, kritikuar, programin e qeverisë por, papritur, u prish rendi i zhvillimit të mbledhjes në Kuvend. Pra, në seancë deputetët u ngritën nga vendet e tyre (unë pashë edhe pamjet filmike, edhe dëshmitarë ishim vetë aty, edhe në procesverbal del qartë) dhe u pengua Kryeministri në prezantimin e tij. U ngrit pretendimi se po fliste një avatar në ekran. Ishte fjala e Kryeministrit, Kryeministri ishte aty, avatari që një instrument teknologjik për të përçuar programin e qeverisë. Programi i qeverisë, përtej asaj që thuhet, nuk ka përcaktuar njeri ministër-robot, ministër është Kryeministri. Kryeministri ka marrë përsipër të ngrejë atë që ai e quan Ministri të Inteligjencës Artificiale, pra përdorimin e instrumenteve teknologjike në qeverisjen e vendit, gjë që e bëjnë edhe shumë shtete të tjera. Kryeministri, si ministri përgjegjës në këtë rast, po përcaktonte një risi, dhe risinë e prezantoi me një mjet elektronik komunikimi. Në të gjithë botën njihet prezantimet, demonstrimet e të dhënave me PoëerPoint. Ne i kemi shpesh nëpër komisione. Sa herë kemi në prezantime të ministrave apo të institucioneve të tjera, që kanë raporte të konsoliduara në mënyrë elektronike për ta thjeshtuar komunikimin me qytetarin?! Çfarë të keqe ka këtu?!”*

Në vazhdim të argumenteve për seancën e datës 18.10.2025, prezantimi i Kryeministrit, nuk u pëlqeu disa deputetëve të pakicës parlamentare, të cilët prishën zhvillimin normal të seancës edhe pse nga ana e qeverisë, nuk pati asnjë shkelje, përkundrazi, ishte reagimi të deputetëve të opozitës, gjë që solli ndërprerjen e seancës

Nga Kryetari i Kuvendit pas rifillimit të seancës u kërkua mirëkuptim dhe procedura u respektua prej tij, por zhvillimi i debatit u bë i pamundur për shkak të cenimit të rendit në seancë. Në këto kushte Kryetari i Kuvendit në interpretim të nenit 116 të Rregullores së Kuvendit, vendosi kalimin në votim të programit të qeverisë. Në këtë proces prevalon vendimmarrja. Për këtë fakt deputeti Gjiknuri iu referua edhe një rasti të ndodhur në vitin 2006 në Kuvendin e Shqipërisë.

Duke iu referuar dhe vendimeve të Gjykatës Europiane në lidhje me rolin dhe kompetencat e Kryetarit të Kuvendit në drejtimin e seancës për mbarëvajtjen e rendit dhe funksionimin normal të seancës, deputeti Gjiknuri vlerësoi se Kryetari i Kuvendit nuk ka shkelur asnjë nen të Kushtetutës, sepse ka qenë përgjegjës për mbarëvajtjen e punimeve, gjithmonë duke respektuar rendin e ditës, që ishte miratimi i përbërjes dhe programit të qeverisë, gjë që u realizua,

pavarësisht kaosit që ndodhi. Rendi dhe siguria, gjatë zhvillimit të seancës plenare, në këtë rast rendi kushtetues dhe mbarëvajtja e punimeve, garantojnë edhe të drejtat që kanë palët politike në Kuvend.

Për deputetët e shumicës parlamentare, anëtarë të Këshillit për Legjislacionin, shkelja e Kryetarit të Kuvendit është inekzistente, sepse nuk ka shkelje faktike, nuk ka shkelur asnjë nen të Rregullores. Seanca plenare nuk është e pavlefshme për shkak se nuk është zhvilluar debati, për shkak të pamundësisë nga ana objektive. Në përfundim të fjalës së tij, deputeti Damian Gjijnuri propozoi që Këshilli t'i kërkojë Kuvendit rrëzimin e kërkesës.

Në përfundim Këshilli për Legjislacionin nuk mundi t'i paraqiste seancës plenare një raport në emër të Këshillit.

Deputetët e shumicës parlamentare vlerësojnë se Kryetari i Kuvendit, z. Niko Peleshi, në drejtimin e seancave plenare të datave 16.9.2025 dhe 18.9.2025 **nuk ka kryer asnjë shkelje të parashikuar në ndonjë dispozitë të Kushtetutës dhe as të Rregullores së Kuvendit, por ka kryer çdo funksion në respektim të parashikimeve kushtetuese dhe atyre ligjore.**

VI. VLERËSIMI I KËRKESËS PËR SHKARKIMIN E KRYETARIT TË KUVENDIT

Kërkesa e paraqitur për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike i është nënshtruar analizës kushtetuese, ligjore dhe faktike.

Kërkesa e 36 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë duhet vlerësuar dhe analizuar në disa aspekte, me qëllim arritjen e një konkluzioni të bazuar në Kushtetutë, në ligj, në prova dhe fakte. Për këtë arsye vlerësimi i kërkesës është konsideruar në aspektin procedural, formal dhe aspektin substancial.

Vlerësimi përfshin:

- Kompetencat kushtetuese dhe ligjore të Kryetarit të Kuvendit, të parashikuara në Kushtetutë dhe Rregulloren e Kuvendit;
- Aspektet formale, procedurale dhe substanciale të paraqitjes dhe shqyrtimit të kërkesës;
- Analizimin në themel të shkeljeve të pretenduara, bazueshmërinë e tyre në fakte dhe prova;
- Konkluzionet për secilën shkelje të analizuar dhe vlerësuar, si dhe;
- Propozimin seancës plenare të votimit të kërkesës së paraqitur.
-

1.6 ASPEKTI PROCEDURAL I SHQYRTIMIT TË KËSAJ KËRKESE

Këshilli për Legjislacionin, bazuar në nenin 114, pika 4, të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi kërkesën e 36 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, në aspektin formal,

procedural dhe substancial dhe në përfundim të shqyrtimit paraqet raportin përkatës në seancën plenare.

Bazuar në nenin 114, pika 4, Këshilli e paraqet raportin në seancë plenare dhe “Në rast se kërkohet, Këshilli për Legjislacionin dhe Kuvendi në seancë plenare janë të detyruar të dëgjojnë Kryetarin e Kuvendit. Në këtë rast seanca plenare drejtohet nga zëvendëskryetari që i përket shumicës parlamentare.”.

Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit nuk kanë asnjë përcaktim për mënyrën dhe shumicën e kërkuar të votave për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit. Për rrjedhojë, në këtë rast gjen zbatim pika 1 e nenit 78 të Kushtetutës, sipas së cilës: “Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.”

Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit sipas nenit 6 të saj dhe, për sa kohë nuk ka një parashikim tjetër, do të përdoret me analogji zbatim i njëjtë. Sipas këtij neni, Kryetari i **Kuvendit zgjidhet pa debat dhe me votim të fshehtë** me shumicën e votave **në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit**.

Sipas nenit 60 të Rregullores së Kuvendit, votimi i fshehtë bëhet për çështje që kanë të bëjnë me personat dhe realizohet duke hedhur në kutinë e votimit fletët e votimit ose në mënyrë elektronike.

Në referim të dispozitave të sipërcituara, edhe procedura e shkarkimit të Kryetarit të Kuvendit do të kërkojë **votim të fshehtë** me shumicën e votave **në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit**.

Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është vlerësuar aspekti formal dhe substancial i saj.

2.6 ASPEKTI FORMAL I PLOTËSIMIT TË KËRKESËS

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 75 të saj formën e emërimit dhe shkarkimit të Kryetarit të Kuvendit duke ia deleguar Rregullores së Kuvendit parashikimin e detajuar të aspektit formal të kërkesës për shkarkimin e tij.

Në nenin 114, pika 1, të Rregullores së Kuvendit parashikohet se: “Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë dhe nga jo më pak se 28 deputetë, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë dhe në ligj.”

Duke iu referuar plotësimit formal të kërkesave të kësaj dispozite të Rregullores, rezulton se kërkesa është firmosur nga 36 deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, është depozituar me shkrim në datën 19.9.2025, me nr. 2509, si dhe rendit disa shkaqe dhe shkeljet e pretenduara nga kërkuesit të lidhura me zhvillimin e seancës plenare të datave 16.9.2025 dhe 18.9.2025. Kërkesa i është drejtuar Këshillit për Legjislacionin, si organi që shqyrton në bazë të nenit 114, pika 4, kërkesën për shkarkim të Kryetarit të Kuvendit.

Sipas nenit 114, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, ku përcaktohet se kërkesa duhet të jetë e motivuar, konkrete për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë, duket se kjo kërkesë përmbushet në aspektin formal, **por në aspektin substancial nuk është e bazuar**, siç do të trajtohet edhe në vijim.

3.6 ASPEKTI SUBSTANCIAL

Kërkesa, bazuar në nenin 114/1 të Rregullores së Kuvendit, që të konsiderohet e bazuar, pavarësisht plotësimit të kriterëve formale, duhet të përmbushë kushtin substancial.

Kushti substancial kërkon që kërkesa e drejtuar për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit për shkeljet e pretenduara të jetë e motivuar dhe për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë, si dhe të vërtetohet me prova e fakte që shkeljet e pretenduara janë kryer

Bazuar në pretendimet e paraqitura në kërkesën e 36 deputetëve, në vlerësimin nëse Kryetari i Kuvendit ka respektuar Kushtetutën dhe dispozitat e Rregullores apo ka qenë në shkelje të tyre, si dhe për të vlerësuar natyrën dhe llojin e shkeljes dhe nëse kjo shkelje përbën shkak që Kuvendi të vendosë shkarkimin e tij, do të analizojmë :

3.6.1 Përgjegjësitë që Kushtetuta i jep Kryetarit të Kuvendit.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 76, pika 1, parashikohet se: “Kryetari i Kuvendit kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhënie me të tjerët.”

Përgjegjësitë kushtetuese të Kryetarit të Kuvendit parashikohen jo vetëm në nenin 76 të Kushtetutës, por në të gjitha nenet e Kushtetutës që lidhen me veprimtarinë parlamentare.

Në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kreut III “Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit” (nenet 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80); kreut IV “Procesi ligjvënës dhe roli kushtetues i tij” (nenet 81, 82, 83), si dhe të rregullimeve për funksionin që parashikon përgjegjësinë e çdo deputeti në ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese gjatë veprimtarisë parlamentare në seancë plenare të Kuvendit, rolit kushtetues të tij jo vetëm në ushtrimin dhe përmbushjen e funksioneve Kushtetuese të Kuvendit, si dhe në zbatim të Rregullores së Kuvendit, bazuar, por jo duke u kufizuar, në parashikimet e neneve 7, 28, 31, 46, 47, 48, 49, 110 dhe nenin 116, pika 1 (*Interpretimi i Rregullores*), analizimi i këtyre rasteve bëhet duke mos abstraguuar nga rasti konkret, bazuar në rrethanat e faktit, duke vlerësuar nëse veprimet ose mosveprimet e Kryetarit të Kuvendit janë në përputhje me frymën dhe rolin që neni 76 i Kushtetutës së Shqipërisë i ngarkon atij.

Gjithashtu, Rregullorja e Kuvendit në nenin 7 përcakton se: “Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme Kuvendit dhe strukturave të tij.”

Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, Kryetari u jep fjalën deputetëve dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, drejton dhe moderon debatet, siguron rendin në seancë plenare, cakton

radhën e votimeve dhe njofton rezultatin e tyre, kujdeset për respektimin e Rregullores së Kuvendit duke marrë masa disiplinore të parashikuara në të, pezullimin e punimeve kur është i pamundur zhvillimi normal i tyre.

Rregullorja në nenin 116, pika 1, parashikon se gjatë zhvillimit të seancës plenare kur ngrihen pretendime lidhur me interpretimin dhe zbatimin e Rregullores, është kompetencë e drejtuesit të seancës për të vendosur për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.

Kompetencat që Kushtetuta dhe Rregullorja i jep Kryetarit të Kuvendit janë të ngjashme me rolin dhe përgjegjësitë parësore të kryetarëve të parlamenteve apo presidentëve të legjislativave, siç është kompetenca të mbikëqyrin dhe rregullojnë debatin parlamentar gjatë seancave plenare. Në përputhje me Rregulloren e Punës së Parlamentit Europian (*Rregullore*)², Presidenti i Parlamentit Europian gëzon të gjitha kompetencat e nevojshme për të drejtuar dhe për të siguruar që punimet e Parlamentit Europian të zhvillohen siç duhet duke qenë përgjegjës për të garantuar respektimin e Rregullores, të ruajë rendin, t'u japë të drejtën e fjalës deputetëve, t'i tërheqë vëmendjen çdo deputeti që prish rendin apo përdor gjuhë fyese, t'i heqë të drejtën e fjalës deri në përjashtimin nga seanca çdo deputeti, i cili vijon me prishjen e rendit apo fyerje, të mbyllë debatet, si dhe të garantojë sigurinë dhe paprekshmërinë e ambienteve të Parlamentit Europian.

Eksperienca parlamentare dhe Rregullorja e Punës e Bundestagut gjerman³ i atribuon gjithashtu një sërë përgjegjësisë Presidentit të Bundestagut (*Presidenti*), të cilat synojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë parlamentare. Kështu, Presidenti mbledh Parlamentin sipas një agjende të caktuar, hap, drejton, pezullon dhe mbyll seancat plenare. Në këtë drejtim, ai iu jep të drejtën e fjalës deputetëve apo iu tërheq vëmendjen kur shmangen nga diskutimi i çështjes që trajtohet në rendin e ditës, shkelin rendin ose nuk respektojnë dinjitetin e Bundestagut. Gjithashtu, Presidenti ka të drejtë të pezullojë seancat plenare kur situatat e krijuara kërcënojnë vijimin e tyre.

3.6.2. Vlerësimi i të gjitha shkeljeve të pretenduara nga kërkuesit.

Kërkuesit pretendojnë se Kryetari ka kryer këtë shkelje: Ka thirrur mbledhjen e Kuvendit, në seancën e datës 16 shtator 2025 në kundërshtim me pikën 3 të nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, duke sjellë pasojën e parashikuar nga pika 2 e nenit 78 të Kushtetutës - mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas Rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.

Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesve vlerësojmë se:

Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 78, pika 2, parashikon se mbledhjet e deputetëve, kur nuk thirren sipas rregullave të parashikuara në rregullore, nuk kanë pasoja juridike.

Nga ana tjetër, Rregullorja e Kuvendit në nenin 27/1, pika 3, përcakton se rendi i ditës i seancës plenare duhet të përcaktohet nga Kryetari i Kuvendit dhe të shpallet si rregull 7 ditë para datës së zhvillimit të saj, por në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga dita e seancës. Ky parashikim ka karakter procedural, me qëllim garantimin e transparencës së punës së Kuvendit dhe për t'iu dhënë mundësi deputetëve për t'u përgatitur për diskutimet në seancën plenare.

² Rules of Procedure of the European Parliament (9th parliamentary term – January 2023).

³ Rules of Procedure of the German Bundestag and Rules of Procedure of the Mediation Committee.

Në analizim të këtyre përcaktimeve të neneve të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit, duhet thënë se Rregullorja e Kuvendit, si akt normativ i miratuar nga vetë Kuvendi, nuk ka të njëjtin nivel hierarkik me Kushtetutën dhe për këtë arsye një shkelje e pretenduar procedurale nuk mund të përbëjë shkak për pavlefshmëri kushtetuese, përveçse kur kjo shkelje prek drejtpërdrejt normën kushtetuese apo të drejtat e deputetëve. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka qenë e qartë në këtë drejtim. Në vendimin nr. 6, datë 10.2.2025, Gjykata theksoi se jo çdo mosrespektim i Rregullores sjell pavlefshmëri absolute. Pavlefshmëria, sipas saj, lind vetëm në ato raste kur shkelja procedurale cenon drejtpërdrejt dispozitat e Kushtetutës ose pengon ushtrimin e të drejtave themelore të deputetëve. Gjykata shprehet gjithashtu se parimi i autonomisë parlamentare u jep institucioneve të Kuvendit një hapësirë të konsiderueshme diskrecionale për organizimin e brendshëm dhe se nuk duhet të bjerë në formalizëm të tepruar, i cili do të paralizonte veprimtarinë parlamentare.

Në rastin konkret, seanca e datës 16 shtator është thirrur nga Kryetari i Kuvendit, pra është respektuar kërkesa e nenit 78, pika 1, të Kushtetutës. Seanca nuk mund të konsiderohet si një mbledhje e “pa thirrur” sipas kuptimit të nenit 78, pika 2, pasi ajo është thirrur nga organi kompetent kushtetues. Edhe nëse rendi i ditës nuk është shpallur në përputhje të plotë me afatin 7-ditor, kjo mbetet një mospërputhje procedurale e natyrës së brendshme, e cila nuk prek as legjitimitetin kushtetues të seancës, as të drejtat përfaqësuese të deputetëve. Në fakt, deputetët kanë qenë të njoftuar për mbajtjen e seancës, kanë marrë pjesë në të dhe kanë ushtruar funksionet e tyre ligjvënëse, çka tregon se e drejta e tyre për të marrë pjesë në procesin parlamentar nuk është cenuar.

Nga kjo analizë rrjedh se pretendimi i pakicës parlamentare është i mbështetur më shumë në një formalizëm procedural sesa në një shkelje të vërtetë kushtetuese. Kushtetuta kërkon vetëm që seanca të thirret nga Kryetari i Kuvendit, gjë që ka ndodhur. Çdo mospërputhje me afatet e shpalljes së rendit të ditës nuk mund të çojë në pavlefshmëri të seancës, përveçse në rastin kur provohet se kjo ka cenuar ndjeshëm funksionimin normal të Kuvendit apo të drejtat kushtetuese të deputetëve. Në këtë rast, një provim i tillë nuk ekziston.

Për pasojë, vlerësohet se seanca plenare e datës 16 shtator 2025 është thirrur në përputhje me Kushtetutën dhe nuk ka asnjë shkak për të konsideruar pavlefshmërinë e saj. Shkelja e pretenduar nga kërkuesit i referohet vetëm aspektit procedural të Rregullores, i cili nuk prodhon efektet e parashikuara nga neni 78, pika 2, i Kushtetutës.

Kërkuesit pretendojnë se Kryetari ka kryer këtë shkelje: Ka thirrur mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në kundërshtim me nenin 83, pika 2, të Kushtetutës, pikën 4 të nenit 28 dhe nenin 117 të Rregullores së Kuvendit.

Kuvendi në datën 11.9.2025, u mbledh në seancë plenare, duke shënuar fillimin e veprimtarisë dhe mandatit të Legjislaturës XI të saj. Në çdo fillim legjislature, Kuvendi miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të cilat kanë rol të rëndësishëm në ushtrimin e funksioneve kushtetuese të Kuvendit. Një grup deputetësh me fillimin e Legjislaturës XI, depozituan projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke propozuar shtimin e numrit të komisioneve nga 8 komisione që parashikonte rregullorja në 11 komisione.

Nisur nga rëndësia që ka emërimi i komisioneve dhe caktimi i anëtarësisë së tyre në funksionimin normal të veprimtarisë së Kuvendit, 30 deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste depozituan në datën 15 shtator 2025 kërkesën për shqyrtimin e ndryshimeve të propozuara me procedurë të përshpejtuar. Projektvendimi për ndryshimin e nenit 19 të Rregullores, si dhe kërkesa për ta shqyrtuar këtë propozim me procedurë të përshpejtuar u ishte njoftuar deputetëve. Ndryshimet e propozuara lidhen me organizimin e brendshëm të Kuvendit dhe nuk prekin asnjë dispozitë Kushtetuese.

Referuar procesverbalit të seancës plenare të datës 16 shtator 2025, paradite, Kryetari i Kuvendit hodhi në votim kërkesën e 30 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektvendimit *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë””, të ndryshuar*, dhe kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për ndryshimin e rendit të ditës të seancës së datës 16 shtator 2025, ora 10:00, duke përfshirë në të edhe projektvendimin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë””, të ndryshuar*. Të dyja kërkesat u miratuan nga Kuvendi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Në vijim, bazuar në përcaktimet e nenit 13 të Rregullores, Kryetari i Kuvendit kërkoi thirrjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për shqyrtimin e projektvendimit të propozuar.

Deputetët kërkues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në këtë rast pretendojnë se: së pari, ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit janë miratuar në mënyrë të njëanshme, duke shkelur traditën e konsensusit ndërpartiak dhe, së dyti, afati njëjavor për shqyrtimin e projektvendimeve me procedurë të përshpejtuar nuk është respektuar, sipas nenit 83, pika 2, të Kushtetutës dhe neneve 27/1, pika 3; 28, pika 4 dhe 117 të Rregullores së Kuvendit.

Sipas kërkuesve, neni 117 i Rregullores parashikon se *“Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedura e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve”* dhe për rrjedhojë mosrespektimi i kësaj procedure, që ndiqet për miratimin e ligjeve dhe për procedurën e përshpejtuar, sjell shkelje të nenit 83, pika 2, të Kushtetutës.

Në vlerësimin e një analize të dispozitave të Rregullores dhe të ndikimit që kanë ato në dispozitat Kushtetuese, rezulton se pretendimi i kërkuesve është i pabazuar duke mos bërë dallimin midis ndalimit kushtetues (vetëm për projektligje) me procedurën e miratimit të një vendimi (për shtesa dhe ndryshimeve të disa neneve të Rregullores), që lidhen me organizimin e brendshëm të Kuvendit.

Rregullorja e Kuvendit ka një natyrë juridike të veçantë, që e diferencon nga ligjet e zakonshme. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar këtë natyrë të veçantë të saj në vendimin nr. 48/2024, duke nënvizuar: *“Rregullorja ka karakter të brendshëm, pasi ka për qëllim përcaktimin e rregullave të organizimit të brendshëm të Kuvendit dhe në këtë drejtim është detyruese vetëm ndaj anëtarëve të Kuvendit dhe administratës së këtij organi dhe pa efekte ndaj të tretëve. Për*

rrjedhojë, për shkak të mungesës së subjekteve të papërcaktuara të së drejtës që ai i drejtohet dhe të fuqisë detyruese të përgjithshme, Rregullorja nuk është një akt me natyrë të mirëfilltë normative në kuptim të përmbajtjes së neneve 116 dhe 131 të Kushtetutës”.

Pikërisht për shkak të natyrës atipike, *sui generis* të këtij akti (rregullore), ajo nuk mund të barazohet dhe nuk mund të trajtohet si një projektligj i zakonshëm. Në këtë kuadër, edhe projektvendimi për ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, edhe pse miratohet me shumicë të cilësuar (absolute) sipas Kushtetutës, ka një natyrë të veçantë juridike, e cila e dallon atë nga projektligjet e zakonshme. Për këtë arsye, në procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të ndryshimeve të saj nuk mund të aplikohen mekanikisht afatet e nenit 83, pika 2, të Kushtetutës, të cilat lidhen me përdorimin e procedurës së përsheptuar për projektligjet dhe vendosin një afat minimal njëjavor për shqyrtimin e tyre.

Sa i përket traditës së miratimit me konsensus ndërpartiak të ndryshimeve në Rregullore, duhet thënë se është një praktikë parlamentare që ka synuar ruajtjen e bashkëpunimit ndërpartiak dhe legjitimitetin e vendimeve duke u aplikuar rast pas rasti në traditën parlamentare. Por është gjithashtu e vërtetë se mosaplikimi i saj për shkak të pamundësisë së arritjes së një dakordësie mes palëve absolutisht nuk gjeneron pavlefshmëri të vendimeve dhe as nuk cenon legjitimitetin e vendimmarrjes, për më tepër kur procedura e Rregullores respektohet dhe Kryetari vepron brenda kompetencave të tij.

Në rastin konkret, Kryetari i Kuvendit ka njoftuar në mënyrë të rregullt mbledhjen e Këshillit për Rregulloren dhe më pas mbledhjen e seancës plenare për shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit.

Për pasojë, pretendimi për shkelje të neneve të Rregullores dhe për cenim të afateve procedurale nuk gjen mbështetje, dhe ndryshimet e miratuara vlerësohet se janë marrë në përputhje me dispozitat e Rregullores bazuar në jurisprudencën kushtetuese për natyrën e saj të veçantë.

1. ***Kërkesit pretendojnë se Kryetari ka kryer këtë shkelje:*** Ka përfshirë në votim akte, të cilat janë miratuar në Kuvend në kundërshtim me procedurën kushtetuese të miratimit, duke shkelur nenin 83, pika 2, të Kushtetutës së Shqipërisë, pikën 4 të nenit 28 dhe nenin 117 të Rregullores së Kuvendit

Edhe pretendimi se Kryetari i Kuvendit ka përfshirë në votim aktet për ndryshimet në Rregullore në shkelje të nenit 83, pika 2, të Kushtetutës, nenit 28, pika 4, dhe nenit 117 të Rregullores, nuk gjen mbështetje. Siç analizuam edhe më sipër, projektvendimet për ndryshimet në Rregullore kanë një natyrë të veçantë juridike, e cila i dallon nga projektligjet e zakonshme dhe për këtë arsye edhe procedura për miratimin e tyre nuk u nënshtrohet mekanikisht afateve për shqyrtimin e projektligjeve të zakonshme.

Referuar procesverbalit të seancës plenare, procedura e ndjekur nga Kryetari është zhvilluar brenda kompetencave të parashikuara në Rregullore dhe është në përputhje me autonominë

parlamentare të garantuar nga Kushtetuta. Për pasojë, pretendimi për shkelje të këtyre dispozitave nuk qëndron dhe procedura e ndjekur konsiderohet ligjore dhe e vlefshme.

Kërkuesit pretendojnë se Kryetari ka kryer këtë shkelje: Në seancën plenare të datës 18.9.2025, i ka mohuar kryetarit të Grupit Parlamentar të PD të drejtën e fjalës për procedurë, në kundërshtim me nenin 49 të Rregullores së Kuvendit, dhe këtë të drejtë ia ka njohur kryetarit të Grupit Parlamentar të PS-së dy herë rresht, duke shfaqur njëanshmëri të theksuar në drejtimin e seancës.

Nëse i referohemi procesverbalit të seancës plenare të datës 18 shtator 2025, rezulton se Kryetari i Kuvendit e ka drejtuar atë në përputhje me nenin 110 të Rregullores së Kuvendit, i cili përcakton hapat proceduralë të zhvillimit të seancës për miratimin e programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave.

Sipas procesverbalit, rezulton se bazuar në nenin 110 të Rregullores së Kuvendit, referuar posaçërisht pikave 2, 3 dhe 4, Kryetari i Kuvendit ka njoftuar se seanca plenare për miratimin e programit politik është ndarë në tri pjesë. “Në pjesën e parë, në bazë të nenit 110, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, Kryeministri i dekretuar do të paraqesë programin politik të Këshillit të Ministrave dhe përbërjen e tij. Në pjesën e dytë të seancës, në bazë të nenit 110, pika 3, të Rregullores, pas paraqitjes së programit politik, çdo deputet dhe grup parlamentar ka të drejtë të paraqesë pyetje për Kryeministrin. Pas përgjigjes së pyetjeve, në pjesën e tretë të seancës, në bazë të nenit 110, pika 4, të Rregullores së Kuvendit, do të deklarojmë hapjen e debatit për programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, si dhe votimin nga Kuvendi të përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave.”.

Ky deklaram reflekton qartë vullnetin dhe angazhimin maksimal të Kryetarit për zhvillimin e seancës në përputhje të plotë me procedurën e përcaktuar në nenin 110 të Rregullores.

Bazuar në këto përcaktime fillimisht fjala i është dhënë Kryeministrit Edi Rama për të paraqitur programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, duke theksuar objektivat e mandatit të ri (shih procesverbal, fq. 3-4), por prezantimi është ndërprerë nga ndërhyrjet e deputetëve të opozitës, të cilët krijuan zhurmë në sallë.

Me qëllim sigurimin e vijimit të prezantimit nga Kryeministri, Kryetari veproi sipas nenit 64 dhe 64/1 të Rregullores, duke paralajmëruar dhe më pas hequr të drejtën e fjalës për deputetët që shkelën Rregulloren për herë të tretë (fq. 5 e procesverbalit).

Por as këto masa disiplinore nuk mundën të qetësonin situatën kaotike të zhvilluar nga deputetët e opozitës në sallën plenare, të cilët vijuan të flasin me zë të lartë, të hedhin në ajër tekstet e Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit dhe të qëllonin me to në drejtim të foltores.

Kjo situatë anormale, me qëllim të qartë për bllokimin e veprimtarisë parlamentare nga një grup deputetësh të opozitës, pengoi jo vetëm zhvillimin normal të seancës, por pengoi edhe pjesën

tjetër të deputetëve, të cilët kërkonin të ushtronin me përgjegjshmëri funksionet e tyre në sallën plenare.

Lidhur me pretendimin e z. Gazment Bardhi se nuk i është dhënë fjala për procedurë nga kryetari, referuar procesverbalit të seancës së kësaj date rezulton se zoti Bardhi kërkoi fjalën për të ndërhyrë gjatë prezantimit të programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave, por ndërhyrjet e tij, bashkë me zotin Balliu, në kundërshtim me procedurën parlamentare dhe të drejtat e deputetit për të marrë fjalën dhe dëgjuar në seancë, shkaktuan ndërprerje e zhvillimit normal të seancës, duke krijuar zhurmë dhe duke penguar rrjedhën e prezantimit. Për këtë arsye Kryetari i Kuvendit reagoi menjëherë, duke iu tërhequr vëmendjen sipas nenit 64 të Rregullores, dhe më pas, pasi ndërhyrjet vazhduan për herë të tretë, u hoq e drejta e fjalës për të dy deputetët sipas nenit 64/2 të Rregullores.

Kjo situatë anormale, me qëllim të qartë bllokimin e veprimtarisë parlamentare nga një grup deputetësh të opozitës, pengoi jo vetëm zhvillimin normal të seancës, por pengoi edhe pjesën tjetër të deputetëve, të cilët kërkonin të ushtronin me përgjegjshmëri funksionet e tyre në sallën plenare.

Kryetari i Kuvendit, në përmbushje të përgjegjësisë së tij në kuadër të veprimtarisë parlamentare në përputhje me nenin 7 të Rregullores së Kuvendit dhe procesin e votimit sipas rendit të ditës, vijoi me zhvillimin e votimit për miratimin e programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave.

Në përputhje me këto fakte, rezulton se shkelja e pretenduar nga kërkuesit argumentohet mbi një pasqyrim jo të drejtë të fakteve dhe provave, dhe në këto kushte pretendimi për këtë shkelje nuk përmbush kushtin substancial, nuk bazohet në prova e fakte dhe për këtë arsye duhet të rrëzohet.

Kërkuesit pretendojnë se Kryetari ka kryer këtë shkelje: nuk ka mundur paraqitjen e programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave nga Kryeministri; ka mohuar të drejtën e deputetëve për të bërë pyetje përpara procesit të votimit; nuk ka lejuar debat parlamentar përpara procesit të votimit, ka mohuar të drejtën e kryetarëve të grupeve parlamentare për të diskutuar në përfundim të debatit parlamentar, në kundërshtim me nenin 97 të Kushtetutës dhe nenin 110 të Rregullores së Kuvendit.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e pretendimit të ngritur nga kërkuesit, po i referohemi përmbajtjes së nenit 97 të Kushtetutës dhe nenit 110 të Rregullores së Kuvendit

Neni 97 i Kushtetutës parashikon: “Kryeministri i emëruar sipas nenit 96, nenit 104 ose 105, i paraqet për miratim Kuvendit, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij.

Neni 110 i Rregullores së Kuvendit parashikon: “Data e seancës plenare për miratimin e programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 97 të Kushtetutës, përcaktohet nga Kryetari i Kuvendit në marrëveshje me Kryeministrin.

2. Programi politik i Këshillit të Ministrave dhe përbërja e tij paraqiten në Kuvend nga Kryeministri.

3. Pas paraqitjes së programit politik, çdo deputet dhe grup parlamentar ka të drejtë të paraqesë pyetje për Kryeministrin.

4. Pas përgjigjeve të pyetjeve, Kryetari i Kuvendit deklaron hapjen e debatit për programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve, në përputhje me nenin 48 të kësaj Rregulloreje. Në përfundim të debatit, pas fjalës së kryetarëve të grupeve parlamentare, ka të drejtë të flasë Kryeministri jo më shumë se 10 minuta. Votimi nga Kuvendi i përbërjes dhe i programit politik të Këshillit të Ministrave bëhet sipas nenit 58 të kësaj Rregulloreje.”

Pra, nga përmbajtja e nenit 97 të Kushtetutës, rezulton se ky nen **nuk kërkon zhvillimin e debatit** si një kusht për vlefshmërinë e votimit. Ai i referohet vetëm **votimit të Kuvendit**.

Neni 110 i Rregullores parashikon që **para votimit për miratimin e programit politik dhe kabinetit qeveritar**, Kuvendi **zhvillon debat parlamentar**.

Neni 97 nuk kërkon zhvillimin e parakusht për vlefshmërinë e procedurës për miratimin e tij. Votimi për programin dhe kabinetin, **nëse është bërë në mënyrë të rregullt**, është në përputhje me nenin 97. Moszhvillimi i debatit **nuk përbën automatikisht shkelje të nenit 97** Kushtetutës.

Në **praktikën parlamentare** (edhe në vende të tjera), **debati është pjesë normale e procedurës**, por **nuk është parakusht absolut për vlefshmërinë e votimit**, për sa kohë votimi ndodh me pjesëmarrjen e deputetëve dhe në përputhje me Rregulloren.

Bazuar në procesverbalin dhe regjistrimin audio – video të seancës plenare, edhe pse lista e folësve të regjistruar në sekretari për rendin e ditës ishte e gjatë, rezulton e provuar se seanca nuk mund të zhvillohej në kushte normale për shkak të rrethimit të foltores nga pjesa dërrmuese e deputetëve të opozitës dhe krijimit të një situatë ku deputetët e opozitës flisnin me zë të lartë nga vendi dhe hidhnin në ajër tekstet e Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit në drejtim të foltores, duke penguar vijimin e prezantimit të programit të qeverisë. Në këto kushte rezulton se ishte e pamundur që debati të zhvillohej në një seancë normale. Deputetët e opozitës, në shkelje të parashikimeve ligjore të Rregullores së Kuvendit dhe parashikimeve ligjore të Kodit të Etikës, kanë cenuar rëndë zhvillimin normal të seancës plenare. Për këtë arsye Kryetari ka kërkuar pesë minuta pushim me qëllim qetësimin e situatës. Por as ky veprim i Kryetarit nuk ka mundur të vendosë qetësinë në sallë dhe situata ka vijuar po njëjloj, gjë që ka bërë të pamundur vijimin e fjalës së kryeministrit për prezantimin e programit. Në këto kushte, bazuar në kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për të kaluar në proces votimi, për shkak të veprimeve penguese të deputetëve të opozitës, Kryetari ka vendosur kalimin në votim të programit të qeverisë dhe përbërjes politike të saj.

Kjo situatë anormale, me qëllim të qartë për bllokimin e veprimtarisë parlamentare nga një grup deputetësh të opozitës, pengoi jo vetëm zhvillimin normal të seancës, por pengoi edhe pjesën tjetër të deputetëve, të cilët kërkonin të ushtronin me përgjegjshmëri funksionet e tyre në sallën plenare.

Nisur nga kjo situatë, ndryshe nga sa parashtrojnë kërkuessit, **nuk është Kryetari i Kuvendit që pengoi zhvillimin e debatit**, por është situata në sallë që **e bën objektivist të pamundur zhvillimin e debatit**. Në raste të tilla, Kryetari i Kuvendit, si drejtues i seancës ka **kompetencën për të administruar seancën**, përfshirë edhe **interpretimin e situatës në raport me Rregulloren**.(neni 116 i Rregullores)

Në rastin konkret, veprimet e Kryetarit të Kuvendit bazohen në kompetencën që neni 116 i Rregullores së Kuvendit i jep atij për të vendosur për pretendimin e ngritur gjatë zhvillimit të seancës plenare lidhur me interpretimin dhe zbatimin e Rregullores,. Ky vendim nuk është objekt diskutimi dhe i jep të drejtë Kryetarit të Kuvendit në vendimmarrjen e tij për votimin e akteve të rendit të ditës.

Zbatimi i përgjegjësiave kushtetuese dhe ligjore nga Kryetari i Kuvendit duhet të shihet për sa i përket zbatimit në germë, por edhe në frymë të Kushtetutës dhe ligjit duke e konsideruar të gjithë bazën ligjore një korpus, i cili nuk mund të merret i veçuar. Bazuar edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 44, datë 7.10.2011, theksohet se “*veprimtaria e çdo deputeti, përfshirë këtu Kryetarin e Kuvendit, duhet të përshkohet gjatë gjithë kohës që ai/ajo e ushtron këtë funksion nga përgjegjshmëria, ndershmëria dhe korrektesa.*”.

Në këtë kontekst sjellim në vëmendje se një interpretim të tillë ka bërë edhe **GJEDNJ-ja në Dhomën e Madhe, datë 17 maj 2016, në çështjen “Karacsony dhe të tjerë kundër Hungarisë”**, aplikimet nr. 42461/13 dhe nr. 44357/13, ku ndër të tjera ka mbajtur qëndrimin se:

“139. ... Ushtrimi i lirisë së shprehjes në Parlament mbart me vete “detyrat dhe përgjegjësitë” të përmendura në nenin 10 § 2 për të garantuar funksionimin efektiv të Parlamentit. Parlamentet kanë të drejtë sipas kësaj dispozite të reagojnë kur anëtarët e tyre përfshihen në sjellje të çrregullta që prishin funksionimin normal të legjislaturës. Ashtu si rregulli i njohur përgjithësisht i imunitetit parlamentar ofron mbrojtje të shtuar, por jo të pakufizuar të fjalës në Parlament, po ashtu duhet të konsiderohen që disa kufizime në fjalën e mbajtur në Parlament – të motivuara nga nevoja për të siguruar që puna parlamentare të zhvillohet në mënyrë të rregullt – duhet të merren parasysh gjithashtu siç justifikohet. Është e rëndësishme të theksohet në lidhje me këtë se Komisioni i Venecias vërejti se në shumicën e parlamenteve kombëtare anëtarët mund t'i nënshtroheshin sanksioneve të brendshme disiplinore nga Parlamenti (shih paragrafët 48-49 të vendimit).

...

155. ... Sanksionet e menjëhershme (të cilat nuk janë në diskutim në rastin konkret) vendosen në rast të një çrregullimi të rëndë të rendit parlamentar dhe për sa i përket masave mbrojtëse procedurale, ato do të kërkonin një paralajmërim. Megjithatë, mund të parashikohet gjithashtu që në raste ekstreme nuk do të kërkohej asnjë paralajmërim. Në këtë kontekst, arsyetimi do të ishte se fjalimi ose sjellja qartazi abuzive e një deputeti anulon mbrojtjen e të drejtës së tij/saj për lirinë e shprehjes ose mund të konsiderohet si shpërdorim i së drejtës.”

Referuar edhe këtij pasazhi të marrë nga vendimi i GJEDNJ-së në Dhomën e Madhe, datë 17 maj 2016, në çështjen “Karacsony dhe të tjerë kundër Hungarisë” e drejta e shprehjes së deputetëve konkurron me parimin e funksionimit normal dhe efektiv të Kuvendit dhe, sipas nenit 76, pika 1, të Kushtetutës, është Kryetari i Kuvendit që kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, etj.

Ndodhur përballë këtij konkurrimi të drejtash dhe parimesh, është detyra funksionale e Kryetarit të Kuvendit që të garantojë funksionimin efektiv të organit legjislativ.

Kushtetuta e Shqipërisë përcakton në nenin 1, pika 1: “*Shqipëria është republikë parlamentare*”, për rrjedhojë Kuvendi ka një rol të rëndësishëm në strukturën juridike dhe shtetërore të vendit. Kuvendi realizon funksione legjislative dhe kontrolluese, të cilat nuk mund të bllokohen apo të vështirësohet realizimi i tyre.

Përdorimi i fjalëve fyese, **zënia me dhunë e foltores së Kuvendit apo pengimi i marrjes së fjalës nga ana e deputetëve, janë metoda që çojnë pikërisht në bllokimin e punës së Kuvendit dhe sjellin pasoja të rënda për sistemin demokratik. Për këtë arsye është detyra parësore e Kryetarit të Kuvendit që të ruajë funksionimin e Kuvendit, si organi i vetëm legjislativ, duke garantuar në këtë mënyrë vijimin e ushtrimit të kompetencave kontrolluese dhe ligjbërëse të këtij organi.** Vetëm në këtë mënyrë realizohet në mënyrë efektive edhe parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Nisur nga situata e krijuar në sallë, Kryetari i Kuvendit konkludoi që **nuk është më e mundur të zhvillohet debat dhe kalojë në procedurën e votimit të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij.** Në këtë rast, **veprimi i Kryetarit nuk përbën shkelje të nenit 110,** por zbatim të situatës së jashtëzakonshme në përputhje me funksionin e tij si drejtues i seancës.

Për sa u analizua më sipër në mënyrë shteruese, shkelja e pretenduar nga kërkuesit nuk përmbush kushtin substancial dhe për këtë arsye duhet rrëzuar.

PËRFUNDIME DHE KONKLUSIONE:

1. Bazuar në analizën e plotë ligjore dhe të fakteve, vlerësojmë se shkeljet e pretenduara në kërkesën e paraqitur nga 36 deputetë për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit, pavarësisht se në aspektin formal dhe procedural plotëson kushtet për t’u shqyrtuar nga Këshilli për Legjislacionin sipas parashikimit ligjor të nenit 114, pikat 1, dhe 4., **nuk plotëson kushtin substancial për shkaqet kushtetuese të kërkuara, me qëllim që të konsiderohen veprimet e Kryetarit të Kuvendit si shkelje.**
2. Kërkesa e depozituar nuk plotëson kushtin substancial, pasi jo vetëm që nuk ka shkelje kushtetuese si një ndër kërkesat e nenit 114/1, por nuk provohet asnjë shkelje për sa pretendohet në kërkesë.
3. Bazuar në vlerësimin e fakteve dhe provave si procesverbali dhe pamjet vizuale e audio të seancës së datave 16 dhe 18 shtator 2025, rezulton se:
 - Kryetari i Kuvendit ka zbatuar me përpikëri të gjitha përgjegjësitë e tij kushtetuese dhe ligjore në drejtimin e seancës plenare. Kryetari i Kuvendit ka treguar frymën e bashkëpunimit dhe tolerancës në drejtimin e veprimtarisë parlamentare në tërësi, duke respektuar më së pari kolegët deputetë të opozitës dhe duke qëndruar mbi palët gjatë drejtimit të seancës.

- Kryetari i Kuvendit gjatë drejtimit të seancave plenare ka treguar maturi duke iu përmbajtur etikës dhe komunikimit edhe atëherë kur provokimet apo mungesa e etikës, si edhe etiketimet nga disa deputetë të opozitës kanë qenë të padenja për misionin që ka deputeti në përfaqësimin e qytetarëve të vendit.
- Kryetari i Kuvendit ka respektuar të gjitha parashikimet kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit në thirrjen dhe drejtimin e seancës të datave 16 dhe 18 shtator, duke moderuar debatin, pa cenim dhe shkelje të etikës, pavarësisht situatës së tensionuar në sallën e seancës plenare nga një grup deputetësh të opozitës parlamentare. Kryetari i Kuvendit i ka zbatuar me përpikëri hapat proceduralë të parashikuar në nenin 110 të Rregullores së Kuvendit, por në mënyrë të provuar rezultoi se kanë qenë veprimet penguese të deputetëve të opozitës, të kryera në shkelje të parashikimeve ligjore të Rregullores së Kuvendit dhe parashikimeve ligjore të Kodit të Etikës, që kanë cenuar rëndë zhvillimin normal të seancës plenare dhe janë bërë shkak për mos vijimin normal të seancës plenare. Bazuar edhe në vendimin e GjEDNJ-së të datës 17 maj 2016, çështja ***“Karacsony dhe të tjerë kundër Hungarisë”***, siç është analizuar edhe më sipër, e drejta e shprehjes së deputetëve konkurren me parimin e funksionimit normal dhe efektiv të Kuvendit dhe sipas nenit 76, pika 1, të Kushtetutës është Kryetari i Kuvendit që *kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij*, etj. Ishte situata e krijuar që e ka çuar objektivisht Kryetarin e Kuvendit në vijimin e procesit të votimit për të garantuar zbatimin e rendit të ditës për votimin e programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave.
- Disa deputetë të opozitës me sjelljen e tyre kanë shkaktuar probleme në zhvillimin normal të seancës plenare për shkak të bllokimit të foltores dhe pengimit të prezantimit të programit politik nga Kryeministri, sipas rendit të përcaktuar të seancës plenare. Kjo ka penguar edhe deputetët e tjerë të të gjitha grupeve parlamentare për të ushtruar të drejtën dhe detyrimin e tyre kushtetues për të drejtuar pyetje dhe për të diskutuar për programin.
- Sjelljet e disa deputetëve të opozitës për moslejimin e zhvillimit normal të seancës, shkelin integritetin dhe figurën e të mandatuarve, cenojnë imazhin e Kuvendit si institucioni më i rëndësishëm në një republikë parlamentare për procesin ligjbërës, për përfaqësimin e qytetarëve.

Në përfundim të analizës kushtetuese dhe ligjore, të analizës së fakteve dhe provave, si dhe shkeljeve të pretenduara nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, **arrijmë në konkluzionin se kërkesa nuk plotëson kushtin substancial, me qëllim që shkelja të jetë për shkak kushtetuese, sipas nenit 114/1 të Rregullores së Kuvendit.**

Nga sa më sipër, arrihet në konkluzion se:

- 1- Seanca plenare e datës 16 shtator 2025 është thirrur në përputhje me Kushtetutën dhe nuk ka asnjë shkak për të konsideruar pavlefshmërinë e saj. Shkelja e pretenduar nga

kërkuesit i referohet vetëm aspektit procedural të Rregullores, i cili nuk prodhon efektet e parashikuara nga neni 78, pika 2, i Kushtetutës.

- 2- **Procedura e ndjekur** nga seanca plenare dhe Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin **nuk cenon nenin 83 pika 2 të Kushtetutës**. Procedura e ndjekur nga Kryetari është zhvilluar brenda kompetencave të parashikuara në Rregullore dhe është në përputhje me autonominë parlamentare të garantuar nga Kushtetuta.
- 3- Seanca plenare e datës 18.9.2025 dhe procedura e ndjekur për miratimin e programit politik të Këshillit të Ministrave dhe përbërja e tij është në përputhje me **neni 97 të Kushtetutës, e cila nuk kërkon zhvillimin e parakusht** për vlefshmërinë e procedurës për miratimin e tij. Votimi për programin dhe kabinetin, **nëse është bërë në mënyrë të rregullt**, është në përputhje me nenin 97. Moshvillimi i debatit **nuk përbën automatikisht shkelje të nenit 97** Kushtetutës. Në **praktikën parlamentare** (edhe në vende të tjera), **debati është pjesë normale e procedurës**, por **nuk është parakusht absolut për vlefshmërinë e votimit**, për sa kohë votimi ndodh me pjesëmarrjen e deputetëve dhe në përputhje me Rregulloren.

Moshvillimi i debatit për miratimin e programit politik sipas parashikimit të nenit 110 të Rregullores, bazuar në rrethanat si u zhvillua seanca, ishte pasojë e veprimeve të kërkuesve të cilët penguan zhvillim e këtij debati

Kryetari i Kuvendit, zoti Niko Peleshi, nuk ka kryer asnjë shkelje të parashikuar në nenit 76, të Kushtetutës dhe as të Rregullores së Kuvendit, duke kryer çdo funksion në respektim të parashikimeve kushtetuese dhe atyre ligjore. Seancat plenare të datave 16.9.2025 dhe 18.9.2025 janë zhvilluar në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe aktet e miratuara në këto seanca nuk cenojnë asnjë dispozitë kushtetuese dhe as nenet 78, 83, pika 2, dhe 79, të Kushtetutës e pretenduara nga kërkuesit .

Në përfundim :

Anëtarët e mazhorancës në Këshillin për Legjislacionin i propozojnë seancës plenare **rrëzimin e kërkesës** për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Niko Peleshi.

Deputetët

Fatmir Xhafaj

Damian Gjiknuri

Olsi Komici

Erion Malaj

Drejtuese e Këshillit për Legjislacionin

Aulona Bylykbashi